

INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

**Seria e kërkimeve politike
BOTIM I VEÇANTË**

VAZHDIMI I RAPORTIT PËR KOSOVËN

PSE PAVARËSI E KUSHTËZUAR?

**KOMISIONI I PAVARUR NDËRKOMBËTAR
PËR KOSOVËN**



qershor, 2005


KIPRED

VAZHDIMI I RAPORTIT PËR KOSOVËN

PSE PAVARËSI E KUSHTËZUAR?

**KOMISIONI I PAVARUR NDËRKOMBËTAR
PËR KOSOVËN**

qershor, 2005



Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën
Vazhdimi i Raportit për Kosovën – Pse Pavarësi e Kushtëzuar?
© Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën

Botuar në bashkëpunim me
The Olof Palme International Center dhe Global Reporting
www.palmecenter.se dhe www.globalreporting.net

Ky libër është përkthyer në gjuhën shqipe nga
botimi i Tryckeriet Äsbrink Grafiska, Solna, 2001
me lejen dhe ndihmën e Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën

Përkthimi dhe redaktimi i këtij botimi është financuar tërësisht nga Olof Palme
International Center (Qendra Ndërkombëtare Olof Palme), Suedi.

Përkthimi: Avni Spahiu

Përgatitja dhe redaktimi: Mentor Agani

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Kodra e Diellit, Rruga 3, Lam. 39
Prishtina, Kosovo (UNMIK)
Phone and Fax: +381 38 555 887
kipred@hotmail.com
www.kipred.net

PËRMBAJTJA

Parathënie	v
Vazhdimi – Pse Pavarësi e Kushtëzuar?	1
Hyrje	1
Konteksti: Zhvillimet Pozitive dhe Negative në Rajonin e Ballkanit	3
Situata në Kosovë dhe Iluzioni i Vetëqeverisjes	8
Rishqyrtimi i Pavarësisë së Kushtëzuar	11
Ndarja	12
Protektorati i Pakufizuar	12
Pavarësi e Plotë	12
Autonomia Brenda RFJ-së Demokratike	13
Pavarësia e Kushtëzuar	14
Drejt Një Progresi Rajonal	19
Përfundimi	23
Fusnotat	26
Shkurtesat	28
Të Dhëna Mbi Komisionin	29
Deklarata e Misionit e 21 Shtatorit	30
Anëtarët e Komisionit	31
Kontributet Financiare dhe të tjera	32

Parathënie

Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën është rezultat i nismës së Kryeministrit suedez, zotëri Göran Perssonit, për ta ofruar një analizë objektive të ngjarjeve para, gjatë dhe pas luftës në Kosovë, dhe për t'i shqyrtuar mësimet e nxjerra nga to. Kryeministri Persson kërkoi nga ne (Gjykatësi Richard Goldstone nga Afrika e Jugut dhe Sekretari i Përgjithshëm Carl Tham nga Suedia) që së bashku ta kryesojmë këtë nismë. Ne mëpastaj i angazhuam edhe 11 anëtarët e tjerë të Komisionit, i cili e filloi punën në shtator të vitit 1999.

Komisioni është i pavarur nga Qeveria e Suedisë, si dhe nga cilado qeveri a institucion tjetër, qoftë kombëtar qoftë ndërkombëtar.

Në tetorin e vitit 2000, Komisioni e botoi Raportin për Kosovën: Konflikti, Reagimi Ndërkombëtar, Mësimet e Mësuara (Oxford University Press). Që nga atëherë anëtarët e Komisionit kanë marrë pjesë në një numër të seminareve, takimeve dhe diskutimeve në lidhje me Raportin dhe përfundimet e tij. Ne dëshirojmë të falënderojmë për përkrahjen e madhe të cilën Komisioni e ka patur, dhe për kohën të cilën na e kanë ofruar shumë njerëz të kualifikuar që ishin të inkuadruar drejtpërsëdrejti në Kosovë. Ne kemi mësuar shumë nga ta.

Komisioni e mbajti mbledhjen e tij të fundit në Stokholm më 8-9 shtator 2001. Me botimin e kësaj shtese të Raportit, detyra jonë përfundon.

Stokholm Shtator 2001

Richard Goldstone

Carl Tham

Vazhdimi

Pse pavarësi e kushtëzuar?

Hyrje

Kjo shtesë është shkruar fare pak kohë para ngjarjeve tmerruese që ndodhën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës më 11 shtator 2001. Lufta globale kundër terrorizmit e ka krijuar një hije të dendur dhe të rëndë mbi pothuaja të gjitha çështjet e tjera ndërkom-bëtare. Ne jemi shumë të brengosur për pasojat e kësaj për popullin kosovar. Do të ishte një përfundim tragjik i luftës së NATO-s të vitit 1999, po qe se Kosova do të har-rohet përsëri, ose, edhe më keq, po qe se Beogradit i lejohet që ta pengojë realizimin e vetvendosjes së popullit kosovar. Deklaratat e fundit nga qeveria e RFJ-së nuk janë shpresëdhënëse. Komisioni ndjehet i obliguar që t'i përkujtojë udhëheqësit e Bashkësisë Ndërkombëtare që statusi i Kosovës nuk është vendosur ende, dhe se lënia e kësaj çështjeje të pazgjidhur është edhe akt mizor ndaj kosovarëve edhe rrezik për stabilitetin në Ballkan.

Legjitimiteti i intervenimit humanitar varet jo vetëm nga ajo se çfarë ndodh gjatë dhe menjëherë pas intervenimit, por edhe nga një program më afatgjatë. Ata që marrin pjesë në intervenimet humanitare e kanë obligim të sigurojnë që veprimet e tyre do të kontribuojnë për një rezultat stabil dhe frytdhënës.

Raporti për Kosovën është botuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Kosovën (të cilit tash e tutje do t'i referohemi vetëm si "Komisioni") në tetor 2000. Ai erdhi në dy konkludime kryesore. Njëri ishte që intervenimi i NATO-s në Kosovë nuk ishte legal por ishte legjitim. Ishte jolegal sepse u bë pa e patur aprovimin paraprak nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara. Intervenimi ishte legjitim sepse në Kosovë ndodhnin shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, sepse të gjitha mundësitë diplo-matike ishin të shpenzuara, sepse Kosova si pasojë e intervenimit u çlirua, sepse shtypja e shqiptarëve kosovarë përfundoi, dhe sepse të gjithë ata që ishin dëbuar nga forcat jugosllave gjatë luftës ishin në gjendje që të ktheheshin nëpër shtëpitë e veta. Konkludimi tjetër i Komisionit ishte që Kosovës duhet dhënë statusin e "pavarësisë

së kushtëzuar.” Kjo e nënkupton një Kosovë vetëqeverisëse, jashtë RFJ-së, mirëpo në kuadër të një kornize specifike ndërkombëtare, në kuadër të së cilës Bashkësisë Ndërkombëtare i mbetet përgjegjësia për sigurimin e kufijve dhe për mbrojtjen e pakicave.

Raporti ka nxitur një interesim dhe diskutim të gjerë. Pyetjet më të shpeshta që iu janë bërë anëtarëve të Komisionit ishin se a janë rekomandimet e tij ende relevante duke i marrë parasysh ngjarjet të cilat kanë ndodhur pas botimit të Raportit. Këto ngjarje përfshijnë:

- Rënien e Milosheviqit nga pushteti dhe vendosjen në Beograd të një qeverie të re të përkushtuar ndaj demokracisë;
- Përhapjen e dhunës në Maqedoni dhe në Jug të Serbisë;
- Shpalljen e një kornize të re kushtetuese për Kosovën.

Kritikët e Raportit e theksonin që dhuna e vazhdueshme dhe niveli i lartë i krimit në Kosovë, vrasjet hakmarrëse dhe dëbimi i serbëve dhe i pakicave të tjera, si dhe përhapja e dhunës në rajonet fqinje e kanë vënë në pikëpyetje legjitimitetin e intervenimit të NATO-s. Është argumentuar, po ashtu, që kërkesa për “pavarësi të kushtëzuar” nuk është urgjente edhe më tutje, pasi që diktatura brutale në Beograd e ka humbur pushtetin dhe se, rrjedhimisht, çfarëdo diskutimi rreth statusit përfundimtar të Kosovës do ta destabilizonte procesin edhe ashtu delikat të demokratizimit në Serbi. Shikuar realisht, ngjarjet e periudhës pas intervenimit i kanë kthyer anasjelltas perceptimet standarde ndërkombëtare të simpatisë për shqiptarët e Kosovës dhe të antipatisë për serbët.

Duke i marrë parasysh këto kritika dhe zhvillime, Komisioni vendosi që ta shkruaj një shtesë të Raportit. Qëllimi ynë është që ta vlerësojmë rëndësinë e propozimeve tona të para duke e marrë parasysh situatën e ndryshuar në Ballkan, ta shtrojmë pyetjen se a mundet intervenimi i NATO-s të konsiderohet legjitim edhe më tutje, duke i patur parasysh zhvillimet pas intervenimit, dhe se a është propozimi ynë për “pavarësi të kushtëzuar” ende me vend. Do të fillojmë duke i përshkruar ngjarjet pozitive dhe negative të cilat kanë ndodhur në rajon pas botimit të Raportit. Mëpastaj do ta shqyrtojmë situatën në vet Kosovë, dhe, në veçanti, implikacionet e kornizës kushtetuese. Kapitulli i tretë do ta rishqyrtojë dhe zhvillojë më tej propozimin për pavarësi të kushtëzuar, ndërkaq, kapitulli i katërt do t'i diskutojë mekanizmat për këtë proces – pra se si mund të arrihet pavarësia e kushtëzuar – si dhe nevojën për një kornizë rajonale.

Konteksti:**Zhvillimet pozitive dhe negative në rajonin e Ballkanit**

Një dukuri pozitive është rënia e nacionalizmit ekspansionist dhe militant nga pushteti. Pas një dekade në të cilën agjendat politike ballkanike ishin të mbizotëruara nga radikalët etno-nacionalistë, rënia e Millosheviqit është përputhur me ardhjen në pushtet në të tërë rajonin të jonacionalistëve dhe/ose të nacionalistëve të moderuar, të cilët janë për ndryshime demokratike dhe të cilët shikojnë kah Perëndimi, dhe në veçanti kah Unioni Evropian (UE), për mbështetje dhe frymëzim politik. Në Beograd, Vojislav Koshtunica është duke e udhëhequr një tranzicion të paqartë: demokracia, ligji dhe mediat e pavarura kanë shënuar një përparim të dukshëm, mirëpo struktura (si dhe personeli) e aparatit ushtarak dhe policor të regjimit të vjetër vazhdon të jetë edhe më tutje me ndikim. Mëtutje, lidhja e popullatës dhe e qeverisë serbe me Kosovën, si simbol i aspiratave kombëtare serbe, vazhdon të jetë e fortë. Dorëzimi i Millosheviqit në Hagë për gjykim nga Tribunali Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi (ICTY) është bërë para së gjithash për shkaqe ekonomike (që ta mundësojë marrjen e ndihmës Perëndimore) dhe, natyrisht, për t'iu shmangur gjykim-it vendës. Sidoqoftë, zbulimi i varrezave masive në Serbi e ka nxitur të menduarit mbi të kaluarën e Serbisë, e që mund të japë një kontribut të rëndësishëm për procesin e demokratizmit, ndonëse ende ekziston kërcënimi i një reaksioni nacionalist. Ardhmëria kushtetuese e Jugosllavisë është ende e paqartë, në veçanti pas fitores së koalicionit malazez për pavarësi, ndonëse dallimi në vota ishte fare i vogël.

Kroacia është distancuar edhe më qartë, si nga qeverisja autoritare e kryetarit të ndjerë Franjo Tugjman, ashtu edhe nga programet ekstreme nacionaliste. Kryetari Stipe Mesiç është deklaruar fare qartë për një bashkëpunim me Tribunalin Ndërkombëtar për Krimet e Luftës. Arrestimi i Gjeneralit Mirko Norac, edhe përkundër demonstratave masive në Split, ishte një akt përplot guxim politik, mirëpo një i cili nuk hasi në mirënjohjen e duhur nga kryeqytetet Perëndimore. Akt i guximshëm ishte, po ashtu, edhe distancimi i tij nga ultranacionalistët në Hercegovinë, të cilët (me përkrahjen e HDZ-së në Zagreb) e kërcënonin jetësimin e Marrëveshjes së Dejtonit. Dhe, në fund, nën udhëheqjen e Mesiçit, Kroacia vendosi ta lejojë kthimin e serbëve të dëbuar nga Krajina, gjatë verës së vitit 1995.

Në Bosnje dhe Hercegovinë po ashtu ka patur zhvillime premtuese. Koalicioni i jonacionalistëve dhe nacionalistëve të moderuar, Aleanca për Ndryshim, erdhi në pushtet pas zgjedhjeve të nëntorit të vitit 2000. Social Demokratët janë tani partia më e madhe në Federatë, duke e zëvendësuar në këtë mënyrë Partinë e Aksionit Demokratik (SDA),

partinë muslimane nacionaliste të ish-Kryetarit Alija Izetbegović. Edhe në Republikën Serbe, qeveria e Millan Ivanovićit duket se është e angazhuar për reforma demokratike, transparencë dhe drejtësi. Kthimi i refugjatëve është shpeshtuar, duke u përfshirë këtu edhe zonat të cilat nuk i kontrollojnë grupet e tyre etnike. Mirëpo, retorika e bashkëpunimit me ICTY-në ende nuk është duke u përcjellur edhe me vepra.

Si shtesë kësaj të tërës është edhe moderimi i qëndrueshëm i Bullgarisë, ndonëse pasojat e zgjedhjes së ish-mbretit në pushtet dhe të luftës në Maqedoni mbeten për t'u parë. Qasja e Greqisë ndaj tërë rajonit, dhe në veçanti ndaj Maqedonisë, është gjithnjë e më konstruktive – qasje kjo e cila është e ndikuar në masë të madhe nga Ministri i Jashtëm George Papandreou, dhe e cila është një pikënisje e mirëseardhur krahasuar me mobilizimet nacionaliste të qeverive paraprake. Qeveria socialiste në Shqipëri, po ashtu, i ka mirëpritur ndërrimet në Beograd, dhe e ka theksuar sërish përkrahjen e saj për integritetin e kufijve si dhe kundërshtimin e saj të dhunës. Në këtë mënyrë, gjendja pas luftrave ballkanike lë përshtypje më premtuese sesa kur është shkruar Raporti; marrë në përgjithësi, rajoni duket i gatshëm për ndryshime demokratike, stabilitet rajonal dhe integrim.

Mirëpo, nëse projekti i nacionalizmit ekspansionist, shkaktar ky i të gjitha luftrave ballkanike të deritashme, e lë përshtypjen sikur është i mposhtur në nivelin e qeverive, një pasojë tjetër e luftërave është edhe një trashëgimi e ndjenjave ekstremiste në nivelin e masave. Traumat e luftërave kanë lënë pas gjurmë të frikës dhe të pasigurisë, të fajësisë dhe të mosbesimit – ndjenja këto të cilat nuk mund të hiqen lehtë, dhe të cilat e kërkojnë mbështetjen të cilën e ofron siguria e identifikimit etnik. Për më tepër, ekonomia e ish-Jugosllavisë është shkatërruar nga lufta dhe shpartallimi i Jugosllavisë. Bruto Prodhimi Vendor (GDP) ka shënuar një rënie të ashpër, dhe papunësia ka arritur nivele të papara – në shumë zona papunësia ka arritur edhe në 40%-50%. Në të tërë rajonin gjatë luftrave është mëkëmbur një ekonomi joformale ilegale, e lidhur me rrjeta kriminale dhe grupe paramilitare, dhe njerëz të shumtë janë ende të varur nga një llojllojshmëri e aktiviteteve joformale të cilat, deri më tash e kanë patur “mbrojtjen” e partive nacionaliste. Dhe së fundit, shoqëria civile dhe forcat politike jonaionaliste, janë të dobësuara nga lufta. Gjatë periudhës 1990-2 në Jugosllavi, dhe në veçanti nëpër qytete, kishte filluar të zhvillohej një trajtë e politikës demokratike. Mirëpo, ishin pikërisht individët urban, të arsimuar dhe laik, të cilët e jipnin mbështetjen për një politikë potencialisht demokratike, ata të cilët u shpërngulën ose në disa raste edhe u vranë, siç ndodhi në Kroaci, Bosnje e Hercegovinë dhe Serbi.

Kjo trashëgimi e nacionalizmit tek masat pasqyrohet në fuqinë këmbëngulëse të partive nacionaliste nëpër disa zona. Partitë në pushtet në Beograd e kanë bërë një fushatë me një platformë nacionaliste, edhe pse demokratike. Në Kroaci HDZ-ja pati rezultate mjaft të mira në zgjedhjet e fundit lokale. Në Bosnje e Hercegovinë, edhe përkundër suksesit të Social Demokratëve, vëzhguesit ndërkombëtarë ishin të dëshpëruar me përqindjen e lartë të cilën partitë nacionaliste ende janë duke e fituar në zgjedhje. Në Mal të Zi partitë për pavarësi sapo e kanë fituar shumicën në zgjedhjet e prillit të 2001. Në ndërkohë, fitorja e partisë nacionaliste maqedonase VMRO dhe e partisë radikale shqiptare DPA në nëntor 1998, pas viteve të qeverisjes Social Demokratë (edhe pse nacionaliste), e paraqet një pjesë të rëndësishme të rrëfimit për konfliktin i cili është duke u shpalosur në Maqedoni.

Edhe më alarmante është, megjithatë, këmbëngulja e incidenteve, protestave, madje edhe e dhunës nacionaliste. Më parë u përmendën demonstratat në Split. Në territorin e Bosnjës, në Hercegovinën Perëndimore, ka patur demonstrata të dhunshme kundër përpjekjeve ndërkombëtare për t'i shpërbërë strukturat e pushtetit nationalist. Dhunë ka patur po ashtu, edhe në Republikën Serbe, kur bashkësia myslimane u përpoq që t'i vendosë themelet për rindërtimin e xhamive të shkatërruara gjatë luftës. Me rastin e kthimit të refugjatëve dhe të të zhvendosurve po ashtu ka patur incidente, si dhe gjatë përpjekjeve për rindërtimin e simboleve fetare e kulturore.

Mbi të gjithat, dhuna në jug të Serbisë dhe në Maqedoni e lë të kuptohet që “Çështja Shqiptare” është larg nga zgjidhja. Në Jug të Serbisë, në fillimin e vitit 2000, u paraqit Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Medvegjës dhe e Bujanocit (UÇPMB). Këto tri rajone ishin shkëputur nga Kosova pas Luftës së Dytë Botërore, në të njëjtën kohë në të cilën disa zona serbe nga jugu i Serbisë iu bashkangjitën Kosovës. Arsyeja e cila u dha për këtë kishte të bënte me vijat e komunikimit me Greqinë, Shqipërinë dhe Turqinë; mirëpo, pasojë e kësaj ishte zvogëlimi i popullatës shqiptare në Kosovë. UÇPMB-ja, si dhe grupet e tjera të armatosura, u zhvillua në Zonën Tokësore të Sigurisë (ZTS) të formuar pas hyrjes së NATO-s në Kosovë në qershorin e vitit 1999. Krijimi i kësaj zone e ka patur për qëllim ndarjen e trupave të NATO-s nga ato jugosllave, dhe në Serbi e në Mal të Zi vetëm policia e armatosur lehtë e ka patur të lejuar që të hynte në këtë zonë. Pas 5 tetorit 2000, qeveria e re serbe hyri në negocia-ta me UÇPMB-në dhe me NATO-n; u arrit një marrëveshje e cila shqiptarëve vendorë u jipte të drejta më të mëdha, dhe e cila e mundësonte demobilizmin, çarmatimin dhe integrimin e luftëtarëve të mëparshëm në forcat lokale të sigurimit, si dhe e lejonte hyrjen e forcave jugosllave në ZTS.

Marrëveshja e Preshevës e paraqet një model se si mund të realizohen negociata të tilla. Elementet kyçe për sukses ishin vullneti politik i qeverisë serbe për të arritur deri te marrëveshja, presioni i NATO-s mbi palën shqiptare, pjesëmarrja e përfaqësuesve të grupeve të armatosura si dhe e shqiptarëve vendës në këtë proces dhe besimi i ndërsjellë i të gjitha palëve në marrëveshje. Rëndësi të posaçme ka patur përpjekja e qeverisë serbe që t'i konsultojë dhe të bisedojë me një numër të madh të njerëzve që jetonin në rajon: kjo qasje, e pranishme si në masa ashtu edhe në elita, e cila i parapriu marrëveshjes, është një risi më rëndësi vendimtare për marrëveshjet paqësore gjetkë.¹ Mirëpo, në afat më të gjatë, sukcesi i marrëveshjes do të varet nga jetësimi i saj efektiv.

Situata në Maqedoni dallon dukshëm. Si edhe UÇPMB-ja, Ushtria Çlirimtare Kombëtare është formuar në ZTS dhe, si edhe UÇPMB-ja, edhe kjo i kishte shumë veteranë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Një numër i shqiptarëve nga Maqedonia ishin anëtarë të Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK), parti majtiste e cila së pari e kishte krijuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, dhe e cila kishte qasje në paratë e diasporës kosovare, përmes fondit Vendlindja Thërret (shih Kapitullin 1 të Raportit për Kosovën). Sikurse edhe në rastin e UÇPMB-së, janë shtruar pyetje serioze rreth mundësisë së zhvillimit të grupeve guerile shqiptare brenda ZTS-së, dhe mbi atë se pse furnizimi nuk është penguar nga KFOR-i. Është sygjeruar që kjo ka qenë e qëllimshme; që para 5 tetorit 2000, amerikanët dëshironin ta destabilizonin Serbinë Jugore. Ky është një shpjegim i pranuar si nga qarqet serbe, ashtu edhe nga ato shqiptare; tek shqiptarët kjo kontribuoi në krijimin e ndjenjës që amerikanët “janë me ne,” dhe se është e mundur të veprohet pa ndëshkim. Një shpjegim shumë më realist është që këto zhvillime kanë qenë pasojë e dëshirës që të mos rezikohen forcat paqeruajtëse. Pasi që një përpjesë shumë e madhe e ushtarëve të KFOR-it është e angazhuar në “mbrojtjen e forcave,” nuk ka resurse të mjaftueshme për ngritjen e sigurisë publike.

Janë dhënë shpjegime të shumta se pse në shkurtin e vitit 2001 filloi dhuna në Maqedoni: që ky shpërthim i dhunës e ka patur për qëllim mbrojtjen e korridoreve të kontrabandës së cigareve, ose të depove të armëve të marra pas marrëveshjes serbo-maqedonase për finalizimin e kufirit; ose që ishte provokim nga ish-paramilitarët jugosllav në rajon; ose, se tani që Kosova është në rrugë drejt zgjidhjes së problemit të saj, koha ishte që të mirremi me të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni, dhe se dhuna është treguar shumë më efektive sesa metodat paqësore në tërheqjen e vëmendjes në probleme. Cilido që të ketë qenë shkaku i shkreptjes së parë, përhapja e dhunës ishte shumë më e shpejtë sesa që ndokush e kishte paramenduar. Qeveria e tashme maqe-

donase është ajo e koalicionit në mes të VMRO-së dhe DPA-së. Para zgjedhjeve të nëntorit 1998, që të dyja këto parti i theksonin pozitat e tyre ekstreme. VMRO-ja, herë pas here e favorizonte një shtet të pastër etnik; ndërsa DPA-ja e favorizonte federalizmin e Maqedonisë, me një pjesë të ndarë perëndimore, të quajtur “Ilirida” nën kontrollin shqiptar. Kur e formuan koalicionin, që të dyja palët e zbutën paksa retorikën e tyre. Situata në Maqedoni nuk ka qenë fare e ngjajshme me atë të Kosovës gjatë regjimit të Millosheviqit para intervenimit të NATO-s. Maqedonia e kishte një qeverisje demokratike, ndonëse shqiptarët, të cilët e paraqesin rreth një të tretën e popullatës, ndjeheshin si qytetarë të klasit të dytë. Ata i kishin disa arsye të mira për këtë: kushtetuta maqedonase Maqedoninë e deklaroi si shtet të popullit maqedon (dmth të sllavëve); gjuhë zyrtare është maqedonishtja, dhe nuk ka pothuajse kurrfarë arsimimi të mesëm ose të lartë në gjuhën shqipe; po ashtu, ka shumë pak shqiptarë në administrimin publik, dhe sidomos në armatë dhe polici.

Situata në Maqedoni dallon, po ashtu, nga ajo në Luginën e Preshevës. Për dallim nga Serbia, qeveria maqedonase, me përkrahjen e qeverive Perëndimore, i është përgjigjur dhunës me një strategji klasike kundër-kryengritëse - pra me bombardimin dhe granatiminin e fshatrave në të cilat mendohej se ishte e vendosur Ushtria Çlirimtare Kombëtare, e që kombinohej me arrestimin dhe torturimin e pohuar të civilëve shqiptarë, me qëllim të identifikimit të anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare.² Pasojë e kësaj ishte përkrahja e popullatës shqiptare, dhe, po ashtu, edhe e partive politike shqiptare të cilat më parë janë munduar që t'i plotësojnë kërkesat shqiptare në mënyrë paqësore (me fare pak sukses), e cila iu dha lëvizjes së Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Pati zhvendosje të qëllimta të popullatës nga të dyja palët, dhe dikund rreth 120.000 njerëz u zhvendosën nga shtëpitë e tyre. Rreth 80.000 refugjatë u strehuan në Kosovë. Në gusht 2001, Bashkësia Ndërkombëtare e arriti marrëveshjen paqësore, e cila në fillimin e shtatorit nën trysinë ndërkombëtare u aprovua nga parlamenti maqedonas; në Maqedoni u dërguan forcat e NATO-s, për t'i mbledhur armët e dorëzuara vullnetarisht nga Ushtria Çlirimtare Kombëtare. Që nga atëherë dikund rreth 50.000 refugjatë janë kthyer në Maqedoni. Përderisa marrëveshja i përmbushi shumicën e kërkesave shqiptare, metodat e përdorura për të ardhur deri te ajo nuk janë së tepërmi premtuese për besimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë në mes të dy bashkësive në të ardhmen. Dhuna e përdorur nga ana e guerilëve shqiptarë, si dhe kundërdhuna e ushtruar, e kanë dobësuar besimin e duhur për vazhdimin e një shteti të bazuar në bashkëjetesën e dy bashkësive të ndryshme.

Po ashtu, nuk mund të ketë besim të madh në perspektivën e kontrollimit të dhunës. Siç e kemi mësuar gjatë dekadës së kaluar, dhuna në këtë pjesë të botës është ngjitëse.

Ajo përhapet përmes pasigurisë për status dhe kufij, aktiviteteve kriminale dhe rrjeteve paramilitare, përmes refugjatëve dhe të të zhvendosurve, dhe për shkak të sjelljeve grabitçare të shteteve fqinje dhe të një numri të “biznismenëve me luftra”.³ Shumë nga faktorët që e shkaktuan dhunën në Maqedoni - niveli i lartë i papunësisë, kontrabanda dhe aktivitetet e tjera ilegale, si dhe pasiguria dhe pakënaqësitë etnike - ekzistojnë edhe në pjesë të tjera të rajonit, si për shembull në Malin e Zi.

Situata në Kosovë dhe iluzioni i vetëqeverisjes

Edhe situata në Kosovë shquhet me zhvillime si pozitive ashtu edhe negative. Zgjedhjet e para të lira komunale që u mbajtën në tetor të vitit 2000 kaluan në një atmosferë jashtëzakonisht paqësore. Lishja Demokratike e Kosovës, partia e moderuar nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës, fitoi bindshëm, kryesisht meqë elektorati i refuzoi pasardhësit e UÇK-së të udhëhequr nga Hashim Thaqi, të cilëve u mvishej niveli i lartë i krimit dhe i dhunës në Kosovë. I Dërguari i ri i Posaçëm i Sekretarit Gjeneral (SRSG), Hans Haekkerup, e ka nxjerrë një kornizë kushtetuese e cila do ta mundësojë mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme të caktuara për nëntorin e vitit 2001. Qeveria e re serbe është duke bashkëpunuar me UNMIK-un; në Beograd është hapur zyra e UNMIK-ut, ndërkaq në Prishtinë është formuar Komiteti për Bashkëpunimin Jugosllav më Kosovë. Po ashtu, ekstremistët serbë janë marginalizuar (për shembull, fondet për grupet paramilitare të Mitrovicës janë ndërprerë), dhe serbët kanë marrë përkrahje më të madhe për të marrë pjesë në jetën politike kosovare. Shërbimi policor ndërkombëtar, si dhe ai vendor, tashmë janë konsoliduar, dhe sistemi juridik është në formim e sipër. Ekonomia është duke u ripërtirë; të hyrat vendëse e paraqesin rreth 70% të buxhetit kosovar për vitin 2001, dhe përkrahja e disaporës për rindërtim ka qenë rreth dyfish më e madhe sesa shumata e donacioneve zyrtare.

Nga ana negative, krimi dhe dhuna janë ende të një niveli të paparanueshëm, edhe pse ky tashmë është duke u stabilizuar. Dhuna etnike është zvogëluar, para së gjithash për shkak se tash pothuaj të gjithë serbët jetojnë nëpër enklava, dhe, rrjedhimisht, liria e tyre e qarkullimit është e kufizuar. Mitrovica tash është e ndarë edhe politikisht edhe ekonomikisht. KFOR-i është treguar njëkohësisht i paafte dhe i pavullnet për ta ndaluar dhunën e vazhdueshme ndaj pakicave etnike. Ky është dështimi më i madh që nga intevenimi i NATO-s i cili, edhe përkundër vështirësive të padyshimta, duhet të kuptohet si një dështim moral. Ende ka shpërthime të protestave dhe të dhunës

nacionaliste, dhe në veçanti në Mitrovicë ku “rojet e urës” në anën serbe e sigurojnë ndarjen e qytetit. Udhëheqësit politik të shqiptarëve kosovarë e lajnë gojën me fjalime kundër dhunës, mirëpo nuk e kanë kryer ndonjë punë të mirëfilltë për ta vënë atë nën kontroll, si për shembull, duke ndikuar në anëtarët e rëndomtë të partive për fillimin e një dialogu dhe bashkëpunimi të mirëfilltë me serbët, apo, në përgjithësi, duke provuar që ta krijojnë një atmosferë tjetër. Mbi të gjithat, udhëheqësit e shqiptarëve kosovarë duken ambivalent në lidhje me dhunën në Maqedoni dhe në jug të Serbisë, dhe janë treguar jo të gatshëm për ta dënuar publikisht UÇPMB-në dhe Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare. Dhe së fundit, numri zyrtar i të papunëve mbetet i lartë, dikund rreth 50%. Aktiviteti ekonomik ilegal është po ashtu, shumë i lartë, duke filluar prej ndërtimeve pa leje e deri te reketimi dhe kontrabanda. Këto aktivitete ilegale i dëbojnë investitorët nga Kosova, qofshin ata ndërkombëtarë apo vendës.

Që nga fillimi i misionit të UNMIK-ut dhe KFOR-it në qershorin e vitit 1999, paqartësia rreth statusit final të Kosovës ka krijuar tension ndërmjet të përfaqësuesve politik vendës dhe të Bashkësisë Ndërkombëtare, si dhe përbrenda vetë Bashkësisë Ndërkombëtare, ashtu siç edhe e patëm paralajmëruar në Raportin tonë. Rezoluta 1244 e KB-së i kishte dhënë për detyrë UNMIK-ut që ta përgatisë Kosovën për një autonomi substanciale dhe vetëqeverisje përbrenda RFJ-së, madje duke e paraparë edhe një prani policore të RFJ-së në Kosovë. Megjithatë, duke e patur parasysh se çfarë përjetoi popullata kosovare nga autoritetet serbe dhe jugosllave – mohimin e të drejtave qytetare, sulmet e fshatrave, masakrimet dhe, më në fund, edhe dëbimin masiv – asnjëherë nuk ishte reale që pas hyrjes së trupave të NATO-s në qershor 1999, të pritët ndonjë ushtrim i sovranitetit të RFJ-së mbi Kosovën. Po ashtu, autonomia substanciale dhe vetëqeverisja ishin të pranueshme për shqiptarët vetëm si një stacion në udhën e tyre për një lloj pavarësie. Brenda vetë UNMIK-ut, si dhe brenda Bashkësisë Ndërkombëtare në përgjithësi, kishte përçarje në mes të atyre që besonin që administrata e KB-së është një mekanizëm kalimtar i cili do t'i përgatisë kosovarët për vetëqeverisje, dhe të atyre që e shihnin UNMIK-un si një protektorat afatgjatë. Gjatë vizitave të shumta të bëra në Kosovë, Komisioni ishte i tronditur nga qëndrimet e pandërprera të një përbuzjeje të një lloji imperialist nga ana e disa elementeve të administratës ndërkombëtare, në lidhje me aftësitë vetëqeverisëse të kosovarëve.

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme, e nxjerrë nga DPSG Hans Haekkerup në majin 2001, pas konsultimeve të kufizuara me faktorët politik vendës,4 i përcakton rregullat për Kosovën para dhe pas zgjedhjeve kosovare në nëntorin 2001. Korniza e kërkon themelimin e asamblesë me përfaqësim të garantuar për pakica; kryetarin, e zgjedhur nga asambleja; dhe kryeministrin e qeverisë të zgjedhur nga

kryetari. Qeveria e Kosovës i ka autoritet mbi çështjet vendëse – ekonominë, arsimin, transportin, administratën lokale, gjyqet, burgjet dhe mediat – mirëpo ky autoritet është i kufizuar nga një numër i madh i fuqive të rezervuara për SRSG-në. SRSG-ja e ka fuqinë që ta shpërbëjë asamblenë dhe të thirrë zgjedhje të reja, t'i përcaktojë “parametrat e gjerë financiar dhe programor” për buxhet, t'i caktojë dhe t'i ndërrojë gjykatësat dhe avokatët, t'i kontrollojë Trupat Mbrojtëse të Kosovës, Drejtoratin Doganor, Drejtoratin për Pasurinë Banesore dhe të Pronës, t'i caktojë të gjithë zyrtarët e lartë ekonomik, t'i mbikëqyrë të gjitha marrëdhëniet e jashtme dhe të bashkëpunojë me KFOR-in në lidhje me sigurinë e brendshme dhe atë kufitare.

Pushteti i tepërta i SRSG-së e ka domethënien që kosovarët, në vend të një vetëqeverisjeje substanciale të premtuar sipas Rezolutës 1244, do ta kenë një autonomi tejet të kufizuar. Ata do ta kenë iluzionin, mirëpo jo edhe realitetin e vetëqeverisjes. Nenet kushtetuese e vejnë në pah një mosbesim të theksuar të ndërkombëtarëve ndaj aftësisë administrative dhe politike të popullit. Mirëpo, në qoftë se përfaqësuesit e Bashkësisë Ndërkombëtare popullin e shikojnë me mosbesim, atëherë edhe populli përfaqësuesit e Bashkësisë Ndërkombëtare do t'i shikojë me mosbesim. Komisioni e beson se populli nuk do të sillet në mënyrë të përgjegjshme përderisa të mos i lejohet që të ketë përgjegjësi. Ka arsye për tu brengosur që një herë pasi që në zgjedhjet e nëntorit 2001 të zgjedhet kryetari, kryeministri dhe qeveria, do të krijohen kushtet për një konflikt rreth pushtetit të rezervuar për SRSG-në, si dhe, në përgjithësi, në mes të elitës politike vendëse nga njëra anë, të përkrahur nga elektorati i vet, për pushtet edhe më të madh vetëqeverisës, dhe të Bashkësisë Ndërkombëtare, në anën tjetër, të vendosur për ruajtjen e pushtetit të saj. Është e mundur që konflikti i cili ka një kohë që po zhvillohet lidhur me mënyrën se si e kuptojnë kosovarët dhe ndërkombëtarët vetëqeverisjen, të shndërrohet në një krizë kushtetuese e cila do ta ndalojë zhvillimin afatgjatë ekonomik dhe shoqëror kosovar.

Situata e pazgjidhur e Kosovës po ashtu ka edhe pasoja të jashtme. E ashtuquajtura “çështje shqiptare” ka të bëjë me faktin që shumica e popullatës shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore mbeti jashtë Shqipërisë, kryesisht në atë e cila atëherë ishte Jugosllavi. Sot janë dikund rreth 400.000 shqiptarë në Serbi, afro 2 milion shqiptarë (90% e popullatës) në Kosovë, dikund rreth 600.000–700.000 në Maqedoni (popullata e përgjithshme e Maqedonisë është dikund rreth 2 milion) dhe 40.000 shqiptarë jetojnë në Mal të Zi. Në vetë Shqipëri rreth 95% të popullatës 3,5-milionëshe janë shqiptarë. Edhe pse gjatë periudhës komuniste ndoshta ka patur ëndrra për një Shqipëri të Madhe, këto u zhdukën kur u pa realiteti, veçmas pas luftës më 1999, kur shumë shqiptarë nga Kosova e kaluan luftën si refugjatë në Shqipëri. Përjetimi i shqiptarëve

që kanë jetuar në ish-Jugosllavi, e cila ishte relativisht liberale, dhe të cilët ishin shpesh herë gatarbajterë nëpër Evropën Perëndimore, dallon radikalisht nga përvoja e shqiptarëve të Shqipërisë, të cilët kanë jetuar në shoqërinë më staliniste/maoiste në Evropë. Ndonëse shumë serbë dhe maqedonas janë të bindur që qëllimi i shqiptarëve është Shqipëria e Madhe, shumica e shqiptarëve, duke i përfshirë këtu edhe vetë luftëtarët guerilë, e theksojnë që qëllimet e tyre janë Kosova e pavarur, të drejtat e shqiptarëve në Serbi, Maqedoni dhe në Mal të Zi, dhe kufijt e relativizuar të cilët do ta mundësonin lëvizjen më të lirë të shqiptarëve dhe takimin e tyre me familjet të cilat tani gjenden në shtete të ndryshme. Ata shpesh e japin si shembull rastin e Gjermanisë, Zvicrës dhe të Austrisë, ku një numër i madh i tyre edhe kanë jetuar.

Pasiguria për statusin e ardhshëm të Kosovës e lë të kuptohet që çështja shqiptare akoma nuk është e zgjidhur, dhe që, rrjedhimisht, çështja e kufijve mbetet e hapur. Larg nga ajo që pavarësia e Kosovës do ta luaj rolin e dominos fillestare, siç është sygjëruar nga disa, sepse do ta nxisë dëshirën për autonomi territoriale në rajone të tjera, pasiguria për të ardhmen e ka domethënien që loja është ende e hapur dhe se edhe Jugu i Serbisë dhe edhe Maqedonia mund të hyjnë në shqyrtim po qe se ndryshojnë rrethanat në terren. Me fjalë të tjera, konfliktet e fundit mund të kuptohen si pasojë e pasigurisë, e cila u jep krah përpjekjeve për t'i ndërruar rrethanat në terren para arritjes së marrëveshjes përfundimtare. Janë pasiguria dhe jostabiliteti ato që e luajnë rolin e faktorëve që do të mund të quheshin “mekanizmat e përhapjes së epidemisë”.

Rishqyrtimi i pavarësisë së kushtëzuar

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nuk e përcaktoi ardhmërinë afatgjatë të Kosovës. Argumenti për pavarësi të kushtëzuar ka themele normative: pra, atë që e drejta për vetvendosje rrjedh nga shkëlja sitematike e të drejtave të njeriut të shqiptarëve kosovarë për një periudhë kohore të gjatë, e që rezultoi me mospajtimin e shqiptarëve të Kosovës me regjimin serb. Në Raport, Komisioni po ashtu i mori në shqyrtim edhe katër opsione të tjera për Kosovën: ndarjen, protektoratin e pakufizuar, pavarësinë e plotë dhe autonominë brenda një Jugosllavie demokratike. Është sygjëruar që zhvillimet e jashtme dhe të brendshme të përshkruara më parë, si dhe klima e ndërruar politike i bënë këto opsione më të favorizuara zgjedhje të mundshme për Kosovën. Mendimi ynë është, megjithatë, që konteksti i ndryshuar nuk e ndryshon argumentin normativ për pavarësi të kushtëzuar. Po ashtu,

duhet të mirret parasysh që konteksti nuk është stabil, dhe se rrethanat mund të ndërrojnë përsëri. Andaj, Komisioni erdhi në përfundim që arsyet për t'i refuzuar katër opsionet alternative janë ende të vlefshme, dhe se ato madje mund të jenë edhe më të arsyeshme pas zhvillimeve të fundit në rajon. E vlen që këto arsye t'i përmbledhim shkurtimisht:

Ndarja

Ky opsion është sygjeruar sërish kohëve të fundit, dhe në veçanti nga Zëvendës-kryeministri i Serbisë, Nebojsa Qoviq. Ai ka propozuar që Kosova të ndahet dhe që Veriu i Kosovës të jetë një entitet i ngjashëm me Republikën Serbe. Ne në Raport i kemi theksuar arsyet parimore kundër ndarjes: një opsion i tillë do të ishte në kundërshtim me “Angazhimin normativ të Bashkësisë Ndërkombëtare për t'i ikur zhvendosjes së popullatës dhe për ta mbështetur karakterin e përzier dhe multietnik të Ballkanit (shih shqyrtimin e opsionit të ndarjes në Raport).” Mirëpo, për këtë qëndrim ka edhe arsye praktike: ky opsion nuk do të pranohej asnjëherë nga shumica e popullatës shqiptare e cila, me apo pa të drejtë, kompleksin xehetar të Trepçës në Veri të Kosovës e shikon si pjesë të dhuntive kryesore natyrore të Kosovës. Ndarja, po ashtu, fare lehtë mund ta nxisë rifillimin e dhunës në Luginën e Preshevës, me qëllim të shkëmbimit të Mitrovicës për Preshevë.

Protektorati i pakufizuar

Ky është opsioni i cili nënkuptohet nga korniza e re kushtetuese. Ky opsion është i papranueshëm për shkak të të gjitha arsyeve që i përmendëm më sipër. Edhe pse protektorati i pakufizuar do ta largonte pasigurinë, nëse pavarësia eliminohet si opsion, tensioni ndërmjet administratës ndërkombëtare dhe kërkesave kosovare për vetvendosje mundet fare lehtë ta arrijë pikën e thyerjes.

Pavarësi e plotë

Përderisa dhuna politike vazhdon, si brenda Kosovës, ashtu edhe në rajonet fqinje, opsioni i pavarësisë është i perealizueshëm. Thjesht, pavarësia e plotë në kontekstin e tanishëm do të ishte e papranueshme si për pakicat ashtu edhe për shtetet fqinje, dhe

do të kishte fare pak gjasa që të aprovohet nga Këshilli i Sigurimit i KB-së, në autoritetin e të cilit mbështetet statusi i tashëm i padefinuar.

Autonomia brenda RFJ-së demokratike

Rënia e Millosheviqit nga pushteti bën që ky opsion i katërt të duket më tërheqës, si për Beogradin ashtu edhe për Bashkësinë Ndërkombëtare. Një opsion i cili momentalisht është duke u diskutuar është ai i “tri republikave,” sipas të cilit Kosova do të bëhej republikë e cila në Jugosllavi do të kishte status të barabartë me Malin e Zi dhe me Serbinë; Rezoluta 1244 i referohet sovranitetit të Jugosllavisë dhe jo të Serbisë, e që e hap mundësinë e ndarjes së Kosovës nga Serbia, mirëpo jo edhe nga Jugosllavia. Natyrisht, kjo mundësi varet nga ajo se çfarë do të ndodh në Mal të Zi. Pas fitores së ngushtë të partive pro pavarësisë në Malin e Zi, në prillin 2001, ekziston një mundësi reale e pavarësisë së Malit të Zi. Po qe se ndodh kjo, atëherë çështja e e pavarësisë së Kosovës do të shtrohet në një mënyrë edhe më të mprehtë. Duke e patur parasysh përçarjen e thellë të shoqërisë malazeze rreth pavarësisë, ekziston po ashtu edhe mundësia që Mali i Zi ta arrijë një kompromis të përkohshëm me Serbinë për një konfederatë të brishtë për një kohë të caktuar. Çfarëdo që të ndodhë, duhet të ketë bashkëpunim si brenda ish-Jugosllavisë, ashtu edhe në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Mirëpo, çështja e statusit përfundimtar të Kosovës nuk duhet të mbetet peng i zhvillimeve në pjesët e tjera të Jugosllavisë. Ky është njëri nga mësimet e dekadës së kaluar; nga shqiptarët e Kosovës u kërkua që të heqin dorë nga kërkesat e tyre përderisa të zgjidhen problemet në Kroaci dhe Bosnje, gjë që krijoi hapësirë për zhvillimin e pakënaqësive. Në Raport Komisioni e argumentoi që edhe në rast të demokrazimit të pjesëve të tjera të Jugosllavisë, megjithatë do të jetë e nevojshme që ky opsion të refuzohet, sepse, pas të gjitha atyre që shqiptarët e Kosovës i kanë përjetuar nga autoritetet jugosllave gjatë më se një dekade, është e pakuptimtë të pritet nga ta që të pranojnë të hyjnë nën çfarëdo qoftë autoriteti jugosllav, sado simbolik që ai të jetë. Ky argument është i vlefshëm edhe më tutje. Përfundimisht, tash që Kosova, në çdo aspekt praktik është hequr nga kontrolli i sistemit legal dhe administrativ serb, është joreale të pritet që shqiptarët kosovarë do të jenë sërish të gatshëm të pajtohen me praninë e zyrtarëve serb, t’i paguajnë tatime Beogradit, apo të kërkojnë pasaporta nga një shtet i cili e ka dëbuar gjysmën e tyre, duke iu shkatërruar dokumentet e identifikimit, për tu siguruar që lidhja në mes tyre është e shkëputur një herë e përgjithmonë, edhe përkundër faktit që, të paktën tash për tash, njerëz të tjerë kanë ardhur në pushtet.

Pavarësia e kushtëzuar

Sipas mendimit të Komisionit, propozimi për pavarësi të kushtëzuar vazhdon të jetë opsioni më i preferuar. Pasi që disa nga faktorët ndërkombëtar duket sikur besojnë që vetëqeverisja e krijuar sipas parimeve kushtetuese të majit 2001, në fakt, nëse jo edhe në emër, don të thotë pavarësi e kushtëzuar, është me rëndësi që ta theksojmë dallimin në mes të vetëqeverisjes nën UNMIK-un dhe pavarësisë së kushtëzuar. Sipas kornizës së re kushtetuese, administrata e KB-së mban për vete të drejta të hollësishme të mbikëqyrjes mbi programin e politikës së brendshme, të policisë dhe të gjyqësisë, si dhe të të gjitha marrëdhënieve ndërkombëtare. Këto fuqi më tepër i përngjasojnë pushteteve gjysëm mbretërore, të cilat janë më të përshtatshme për një vend të varur kolonial, sesa për një popull vetëqeverisës. Sipas idesë së Komisionit mbi pavarësinë e kushtëzuar, pushteti mbi programin e politikës së brendshme, i cili tash është i rezervuar për SRSG-në do të duhej të bartet dalngadalë në qeverinë kosovare; në fund Kosova do të jetë e pavarur dhe jashtë RFJ-së, sado e kushtëzuar që të jetë kjo pavarësi. Nuk ekziston asnjë arsye koherente se pse vetë kosovarët nuk do të mund ta kishin kontrollin mbi parametrat financiar dhe programor të buxhetit të tyre, dhe në veçanti tash, kur më tepër se 70% e të ardhurave administrative të krahinës mblidhen nga vetë Kosova, dhe nuk vijnë më nga burimet ndërkombëtare. Komisioni, po ashtu, nuk e sheh asnjë arsye bindëse se pse qeveria kosovare nuk do të mund ta kishte kontrollin mbi çështjet si doganat, gjykatat, shërbimin policor, pronën shoqërore dhe shtetërore, hekurudhat dhe transportin, aviacionin civil, drejtoratin e pasurisë bane-sore dhe të pronës, pronën komerciale, kufijtë komunal, rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me armët e zjarrit - pra një numër të madh të pushteteve të rezervuara për SRSG-në sipas Kapitullin 8.1, seksionet a-z, dhe 8.2, si dhe pushtetet e tjera që i jipen SRSG-së sipas Kapitullit 12. Po qe se nuk ekziston ndonjë arsye e fortë që këto pushtete t'i mohohen qeverisë kosovare, Komisioni e parashih fillimin e një lufte për t'i fituar ato.

Përpos pushtetit mbi politikën e brendshme, të përshkruar më lartë, Komisioni beson që qeveria kosovare duhet ta ketë edhe pushtetin që të negociojë me faktorin ndërkombëtar të sigurimit, KFOR-in, dhe të bëjë prezentime para tij, si dhe të hyjë në negociata me agjencionet ndërkombëtare dhe me qeveritë e huaja. Është me një rëndësi të posaçme që qeveria e re kosovare të zhvillojë raporte paqësore me të gjithë fqinjët e saj, dhe në veçanti me Maqedoninë dhe me Serbinë. Po qe se marrëdhëniet ndërkombëtare të entitetit të ri mbesin ekskluzivisht në kompetencë të SRSG-së, kosovarëve nuk do tu mbetet asnjë motivim që të sillen në mënyrë të ndërgjegjshme ndaj

fqinjëve të tyre.

Cilët do të duhej të ishin atëherë kufijt që do t'i imponoheshin kësaj vetëqeverisjeje? Kushtet specifike për pavarësi do të ishin rezultat i një procesi të shqyrtimit të matur brenda Kosovës dhe me fqinjët e saj. Komisioni i propozon, si pika fillestare, këto katër kushte:

Mospranimin e qartë të çfarëdo ndërrimi të kufijve d.m.th. mospranimin e qartë të projektit të Shqipërisë së Madhe, ose madje edhe të Kosovës së Madhe (e cila do t'i përfshinte, për shembull, Luginën e Preshevës dhe Maqedoninë Perëndimore). Me fjalë të tjera, udhëheqësit politik kosovarë duhet të heqin dorë nga logjika nacionaliste e cila kërkon që grupet etnike duhet të jenë të përputhshme me kufij. Ndërkohë që ata mund t'i përkrahin të drejtat shqiptare në shtetet e tjera dhe të bashkëpunojnë me fqinjët e tyre, ata duhet, po ashtu, ta theksojnë përkushtimin e tyre ndaj mosndërhyrjes dhe integritetit territorial.

Garancioni kushtetues për të drejtat e njeriut për të gjithë qytetarët e Kosovës. Kjo don të thotë që pakicat do të kanë qasje dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje në institucionet e Kosovës, duke e përfshirë gjyqësinë, shërbimin policor dhe postet e fituara në zgjedhje, si dhe të drejtat e mbrojtura ndërkombëtarisht për shërbimet qeveritare dhe arsimimin në gjuhën e tyre. Një garancion i tillë kushtetues duhet të jetë më shumë sesa vetëm fjalë në letër: ai duhet të përvetësohet në mënyrën e mendimit dhe të sjelljes në jetën politike kosovare. Duhet të ketë përpjekje të mirëfillta drejt bashkëpunimit, dialogut dhe pajtimit ndërmjet grupeve të ndryshme në Kosovë. Posaçërisht, duhet synuar drejt krijimit të kushteve në të cilat serbët të cilët janë arratisur nga Kosova do ta ndjejnë që po qe se dëshirojnë mund të kthehen në Kosovë, dhe që t'i mundësohet pjesëmarrja në jetën shoqërore pakicave të cilat janë në Kosovë.

Heqja dorë nga përdorimi i dhunës si mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të brendshme ose të jashtme. Duhet të ketë përpjekje të sinqerta, si nga udhëheqësit politik kosovarë, ashtu edhe nga shoqëria civile, që në Kosovë të ndërtohet kultura e cila është e prirur kundër dhunës. Nuk mjafton që kundër dhunës vetëm të flitet: duhet të shihen veprimet reale për pengimin dhe dënimin e dhunës, si brenda Kosovës ashtu edhe jashtë saj. Udhëheqësit politik kosovarë duhet të heqin dorë qartë nga çfarëdo qoftë përpjekje për përdorimin e dhunës për përmbushjen e kërkesave shqiptare, si dhe të distancohen qartë nga grupet si UÇPMB-ja dhe UÇK-ja.

Angazhimi për bashkëpunim rajonal, qeverisje rajonale dhe institucione të qëndrueshme rajonale.

Mbikëqyrja efektive e këtyre kushteve e kërkon një prani të vazhdueshme ndërkom-bëtare në Kosovë, e cila do të jetë e ngarkuar me përgjegjësi të posaçme për mbrojtjen e kufijve dhe të pakicave. Kosova është një shoqëri e përçarë, e cila edhe për një kohë mjaft të gjatë do të ketë nevojë për një prani të sigurisë dhe të ndihmës ndërkom-bëtare. Duhet të ekzistojnë mekanizma institucional me anë të të cilëve Bashkësia Ndërkombëtare mund të veprojë kur dhuna ndërsqepërore ose shkelja e të drejtave të pakicave e kërcënojnë stabilitetin e krahinës, dhe/ose kur qeveria e Kosovës tregohet e paaftë ose e pavullnet për të vepruar, ose që ta parandalojë ndonjë ndërhyrje të armatosur në shtetet fqinje. Prandaj, fuqitë e Bashkësisë Ndërkombëtare, të cilat mund të mbeten qoftë si kompetenca të SRSG-së, qoftë në ndonjë trajtë tjetër, duhet të kufizohen në fushën e mbrojtjes së pakicave, garantimin e të drejtave individuale të njeriut dhe të integritetit të kufijve; dhe këto fuqi duhet të ushtrohen vetëm atëherë kur autoritetet vendore qartazi të dështojnë në kryerjen e detyrave të tyre kushtetuese. Në afat të gjatë, përderisa qeveria kosovare t'i forcojë aftësitë e saj administrative dhe politike, dhe përderisa situata në rajon të bëhet më e favorshme për paqe, duhet të bëhet e mundur që roli i Bashkësisë Ndërkombëtare të shkojë duke u zvogëluar edhe më tutje dhe që populli kosovar të merr mbi vete edhe më shumë përgjegjësi. Kjo është ardhmëria e paramenduar me idenë e pavarësisë së kushtëzuar. Dhe kjo është në tërësi e ndryshme nga vetëqeverisja e kufizuar nën UNMIK-un.

Pavarësia e kushtëzuar është njëkohësisht edhe qëllim edhe proces. Qëllimi është sovraniteti dhe pavarësia për popullin e Kosovës, në suazat e përcaktuara nga Bashkësia Ndërkombëtare – domethënë, me kusht që Kosova ta respektojë integritetin territorial të fqinjëve të saj, ta ruaj paqen e brendshme dhe t'i respektojë të drejtat e njeriut, si dhe ta mundësojë mbrojtjen e traditave dhe të institucioneve të komuniteteve pakicë. Pavarësia e kushtëzuar nuk e anashkalon (në fakt, kjo, me gjasë, edhe e kërkon) zhvillimin e raporteve të afërta me fqinjët e Kosovës, sidomos me entitetin i cili do ta zëvendësojë RFJ-në. Mirëpo këto marrëdhënie të reja më së miri do të mund të zhvillohen në baza vullnetare, nga pozita fillestare e pavarësisë sovrane. Po ashtu, nga vetë populli i Kosovës do të varet se çfarë do të jenë këto raporte, e të cilat do të vendosen në negociatat e lira me fqinjët e tij. Pavarësia e kushtëzuar është një proces i bartjes progresive, në të cilin fuqitë që momentalisht janë në kompetencat e Bashkësisë Ndërkombëtare, pra të SRSG-së, do të transferohen progresivisht në zyr-tarët e zgjedhur vendës. Qëllimi i pavarësisë së kushtëzuar është që pushteti i cili është në kompetencat e Bashkësisë Ndërkombëtare të bartet sërish aty ku duhet të jetë, tek populli i Kosovës.

Janë tri argumente kryesore që janë dhënë kundër këtij propozimi. I pari ka të bëjë

me çështjen e demokracisë në Serbi. Zyrtarë serbë dhe komentatorë ndërkombëtarë shpesh herë argumentojnë që tash nuk është momenti i duhur për ta shqyrtuar çështjen e statusit të ardhshëm të Kosovës, meqë kjo mund ta pengojë përparimin serb drejt demokracisë – d.m.th. që kjo çështje mund të shfrytëzohet nga politikanët ekstremistë dhe mund ta largojë vëmendjen nga punët e përditshme urgjente. Është e padyshimtë që një Kosovë e pavarur, edhe formalisht jashtë RFJ-së, sado e kushtëzuar që kjo pavarësi të jetë, është diçka që vështirë mund të gëlltitet nga një numër i madh serbësh. Andaj edhe është shumë e rëndësishme që udhëheqësit shqiptarë të Kosovës të kontaktojnë me Beogradin dhe t'i fillojnë pikërisht tash diskutimet rreth mundësive për ndërtimin e një raporti të ri. Një diskutim i tillë duhet t'i përfshijë krijimin e kushteve për kthimin e refugjatëve, mbrojtjen e vendeve në Kosovë që kanë rendësi historike për serbët, kërkimin e të zhdukurve, shkëmbimin e të burgosurve si dhe bashkëpunimin ekonomik.

Si pasojë e luftës, ende mungojnë rreth 3.000–4.000 persona, shumica shqiptarë kosovarë. Është një kërkesë legjitime e serbëve dhe e shqiptarëve të Kosovës që UNMIK-u, si dhe autoritetet e tjera relevante të bëjnë më shumë përpjekje, dhe të japin më shumë mjete, për të zbuluar se çfarë ka ndodhur me ta. Sipas të gjitha gjasave, shumica prej tyre janë të vdekur. Deri më tash, ekshumimi, si në Kosovë, ashtu edhe në Serbi, ka qenë tepër i ngadalshëm.

Rreth 200–300 shqiptarë nga Kosova janë duke u mbajtur ende nëpër burgjet serbe si të burgosur politik. Qeveria në Beograd duhet t'i lëshojë këta persona sa më parë. Ky është hapi i parë drejt pajtimit.

Komisioni mendon që çfarëdo shtyrje e çështjes së statusit të Kosovës do ta vështirsojë zgjidhjen e saj më vonë, dhe atë jo vetëm në Kosovë, por edhe në vetë Serbi. Si edhe në rastin e bashkëpunimit me Tribunalin për Krimet e Luftës, është më e lehtë që vendimet e vështira të mirren tash, kur popullariteti i regjimit post-Milloshëviqian është i madh, sesa më vonë, kur euforia të bjerë. Pavarësia e kushtëzuar e Kosovës mund të merret si një çmim që duhet paguar për çlirimin e demokracisë serbe nga iluzionet nacionaliste, duke e hapur rrugën drejt pajtimit me fqinjët e saj dhe perspektivën e “kthimit në Evropë.” Pas një dekade përplot luftra, shoqëria serbe është e lodhur dhe asaj i nevojitet “normaliteti.” Koshtunica mund t'a përdorë profilin e tij nacionalist dhe madantin demokratik në një mënyrë fort të mirë, duke e bërë një kthesë të qartë nga koha e Millosheviqit dhe e mitit mbi “ripushtimin serb të Kosovës.” Në Serbi është një prirje që 5 tetori 2000 të trajtohet si ‘Dita Zero’; mirëpo Serbia duhet të ballafaqohet me të kaluarën e saj si parakusht, si për kthimin në “nor-

malitet,” ashtu edhe për demokratizimin e saj dhe për bashkëpunim rajonal.

Argumenti i dytë kundër pavarësisë së kushtëzuar është i ashtuquajtur i domino-efektit. Është thënë që pavarësia e kushtëzuar do të nxiste kërkesa për pavarësi në Mal të Zi dhe për ndarje në Bosnje e Hercegovinë dhe në Maqedoni, si dhe kërkesa përbrenda vetë Serbisë, në Vojvodinë dhe në Sanxhak. Janë katër argumente për hedhjen poshtë të një qëndrimi të tillë. Së pari, parakushtet për pavarësi të Kosovës, të dhëna më sipër, e përjashtojnë mundësinë e çfarëdo provokimi direkt nga Kosova; pra, heqja dorë nga logjika nacionaliste, refuzimi i dhunës dhe angazhimi për mosintervenim e kanë domethënien që nuk mund të ketë pasoja direkte për fqinjët e Kosovës, dhe mëtutjje, prania e vazhdueshme e Bashkësisë Ndërkombëtare do ta garantonte plotësimin e këtyre kushteve. Së dyti, pavarësia e Kosovës do ta largonte pasigurinë e cila është e shkakuar nga karakteri i përkohshëm i statusit të tashëm të Kosovës, dhe në këtë mënyrë, siç u tha më lart, do ta zvogëlonte motivimin për ta ndryshuar gjendjen në terren. Së treti, është me rëndësi ta theksojmë të drejtën normative për pavarësinë e Kosovës. Nga pikëpamja legale, argumenti për vetvendosjen e shqiptarëve të Kosovës buron nga shkëlja sistematike e të drejtave të njeriut për një periudhë të gjatë kohore. Argumenti i njëjtë nuk mund të përdoret nga serbët e Bosnjes apo nga shqiptarët e Maqedonisë. Në fakt, cilido grup i cili do të ketë fytyrë që të thotë se situata e tyre mund të krahasohet me atë të shqiptarëve të Kosovës para vitit 1999, siç u bë në Maqedoni, duhet të kritikohet rreptë. Dhe së katërti, është vështirë ta shohim ndonjë arsye se pse cilido nga opsionet e tjera alternative të propozuara nuk do ta shkaktonte domino-efektin tek fqinjët e Kosovës. Si në rastin e Serbisë, është me rëndësi që udhëheqësit politik shqiptarë, ta fillojnë dialogun dhe bashkëpunimin me fqinjët e tyre, ashtu që t'i bindin ata për vullnetin e mirë dhe respektin të cilin Kosova e ka për integritetin e tyre.

Argumenti i tretë që bëhet kundër çfarëdo ndryshimi të statusit të Kosovës ka të bëjë me Këshillin e Sigurimit. Është thënë që çfarëdo përpjekje për tu larguar nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të KB-së, do ta kërcënonte kompromisin e arritur me Rusinë – që Kosova të mbetet përbrenda kufijve të Jugosllavisë, e që ishte me rëndësi për ta arritur fundin e intevenimit ushtarak të NATO-s. Mirëpo, siç e kemi theksuar edhe më parë, situata e tashme në Kosovë është e papranueshme. Rusia do ta kundërshtonte pavarësinë e Kosovës, mirëpo nuk mund të paramendohet se si ajo do ta ndalonte zgjidhjen, po qe se do të arrihet një marrëveshje paraprake rajonale. Andaj është me edhe më shumë rëndësi që NATO-ja dhe BE-ja të ushtrojnë tryzni në qeveritë rajonale për arritjen e një marrëveshjeje të tillë, të bazuar në realitetet e reja.

Koncepti klasik i sovranitetit, ai i shekullit 19, i cili rallë herë ka arritur të realizohet në praktikë, është ai i sovranitetit absolut territorial. Në shekullin e 21-të, sovraniteti është patjetër i ndarë dhe i varur nga marrëveshjet me një numër të madh të faktorëve ndërkombëtar.

Në Ballkan, koncepti sovranitetit i shekullit 19, shpesh herë i theksuar nga udhëheqësit nacionalistë, është sinonim i pasigurisë dhe i rrezikut të ripërtëritur për luftë. Një sovranitet vërtet i sigurt në Ballkan – dhe gjithkund, edhe në Evropë dhe edhe në botë – është ai i cili është i kushtëzuar nga marrëveshjet ndërkombëtare. Sa i përket Kosovës, sovraniteti i kushtëzuar është mënyra e vetme e cila do ta bënte pavarësinë e Kosovës të pranueshme për fqinjët e saj dhe e cila do të rriste shkallën e sigurisë.⁵ Një dallim i rëndësishëm në mes të sovranitetit të propozuar për Kosovën dhe të atij që ekziston në vendet e tjera të botës, është ai që karakteri kushtëzues i sovranitetit kosovar nuk është zgjedhur me dëshirë, që ky duhet të jetë i qartë dhe i kodifikuar, dhe që, po ashtu, duhet të jetë i mbikëqyrtur në mënyrë të qartë. Me fjalë të tjera, pavarësia e kushtëzuar në rast të Kosovës ka përmbajtje specifike. Kjo don të thotë se pavarësia mund të arrihet vetëm në bazë të disa kushteve të caktuara përmbajtja ndaj të cilave, edhe pas arritjes së pavarësisë, do të mbetet përgjegjësi e Bashkësisë Ndërkombëtare. Pra, sovraniteti do të jetë i mbikëqyrtur në mënyrë eksplicite.

Drejt një progresi rajonal

Si mund të arrihet kjo pavarësi e kushtëzuar? Një deklaram i qartë nga ana e Bashkësisë Ndërkombëtare, i cili do të jipej menjëherë pas zgjedhjeve të nëntorit, për angazhimin e saj drejt pavarësisë së kushtëzuar, do ta parandalonte debatin destruktiv me udhëheqësinë e porsazgjedhur kosovare. Edhe pa një kësi deklarate, udhëheqësit e ri kosovar mund ta caktojnë agjendën e tyre për një proces i cili do të shpiente drejt pavarësisë. Ata munden të:

shprehin angazhimin e tyre për plotësimin e kushteve për pavarësi, të theksuara në këtë tekst, sidomos dorëheqjen nga dhuna dhe respektimin e tyre për integritetin e kufijve;

fillojnë një proces të dialogut afatgjatë, brenda Kosovës dhe me fqinjët e saj, rreth mënyrave se si mund të plotësohen këto kushte. Ky dialog duhet t'i inkuadrojë të dy llojet e udhëheqësve politik, d.m.th. përfaqësuesit e zgjedhur si dhe shoqërinë civile.

Dialogu posaçërisht i rëndësishëm do të jetë ai më RFJ-në, në mënyrë që si udhëheqësit ashtu edhe popullata e rëndomtë ta kuptojnë që Kosova nuk është më pjesë e RFJ-së, mirëpo e cila dëshiron të bashkëpunojë seriozisht rreth çështjeve siç janë mbrojtja e monumenteve historike dhe kthimi i refugjatëve;

negociojnë me UNMIK-un rreth një kornize të re kushtetuese, e cila gradualisht dhe progresivisht do ta barte fuqinë momentale të SRSG-së në qeverinë kosovare, përdërisa ajo t'i ndërtojë kapacitetet e saja administrative dhe organizative.

Procesi i dialogut duhet të mirret si pjesë e një procesi më të gjerë rajonal, të cilin Bashkësia Ndërkombëtare do ta udhëheq me qëllim që ta mundësojë zgjidhjen, dhe jo që ta imponojë atë. Kohëve të fundit është një interesim i konsiderueshëm për mbajtjen e një konference të re për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve të pazgjidhura në rajon, e cila do ta ketë për qëllim eliminimin e pasojave përhapëse të pasigurisë. Mirëpo në dekadën e fundit janë mbajtur për së tepërmi shumë konferenca ndërkombëtare - Konferenca e Londrës më 1992, Dejtoni e Rambujeja, janë vetëm disa nga to - të cilat dështuan qoftë në arritjen e vendimit përfundimtar, qoftë në jetësimin e këtyre vendimeve. Problemi qenësor ishte ai që ky lloj i konferencave elite dështon në shqyrtimin e çështjes kryesore: atë të raportit në mes të vendimeve formale (rreth sovranitetit, kufijve ose kushtetutës), dhe jetës së përditshme. Shumica e ish-jugosllavëve kanë përjetuar regjime tejet të centralizuara dhe autoritare, me udhëheqje nga lartë, dhe kjo, pjesërisht edhe e shpjegon preokupimin me çështje formale. Mirëpo, janë zhgënjimet që krijohen nga jeta e përditshme, ato të cilat i krijojnë parakushtet themelore për nacionalizmin e masave. Çështje kryesore është se në çfarë mënyre të decentralizohet dhe të demokratizohet jeta e përditshme, ashtu që çështjet si sovraniteti dhe kufijtë ta humbin rëndësinë. Duke e patur parasysh këtë mënyrë të mendimit, çdo qasje drejt marrëveshjes përfundimtare do të duhej t'i kombinonte vendimet afatgjata rreth kornizës formale, me raporte të ndryshuara në mes të kornizës formale dhe proceseve joformale - d.m.th., të krijohet një natyrë e ndryshuar e sovranitetit, ku kufijtë dhe simbolet janë më pak të rëndësishme. Që koncepti i ndryshuar i sovranitetit të jetësohet në afat më të gjatë, duhet që qasja e marrëveshjes të jetë më pak e diktuar nga lartë; do të ketë nevojë më të madhe të inkuadrimit të grupeve civile dhe të komunave në procesin e arritjes së marrëveshjes përfundimtare.

Një proces regjional i këtij tipi, i cili mund të përfundojë më një konferencë dhe marrëveshje përfundimtare, është i ngajshëm më atë që është duke e propozuar Ministri i Jashtëm i Jugosllavisë, Goran Svilanović, në trajtë të një Procesi Ballkanik të Helsinkit. Një proces i tillë do të duhej t'i kombinonte tri elemente:

Çështjet klasike të Helsinkit – kufijtë dhe të drejtat e pakicave;

Çështjet e reja që kanë të bëjnë me raportin në mes të vendimeve formale (kufijt, kushtetutat, simbolet e sovranitetit) dhe jetës së përditshme.

Deri më tash, kjo është diskutuar kryesisht në lidhje me çështjet ekonomike; prandaj, korniza e Paktit të Stabilitetit i ka kushtuar rëndësi të veçantë masave programore, si liberalizimit të tregut dhe infrastrukturës së përbashkët. Mirëpo, çështjet e tjera janë po ashtu me rëndësi. Kooperimi i Këshilli Nordik mund ta ofrojë një model për kësi qasje. Çështjet për diskutim mund t'i përfshijnë këto pika:

Pajtimin. Pengesa më e madhe për integrimin e serbëve dhe shqiptarëve në shoqërinë kosovare, statusi përfundimtar i Kosovës, apo për integrimin e sllavëve dhe të shqiptarëve në shoqërinë maqedonase, është mungesa e një të vërtete të përbashkët rreth ngjarjeve që ndodhën në dekadën e fundit, e cila do t'i pajtojë dhe tejkalojë verzionet kundërshtuese të cilat ekzistojnë momentalisht. Shpjegimet që bëjnë gara në viktimizim dhe kronologjitë jokonsistente janë pengesa për pajtim më të gjërë rajonal. Ekzistojnë propozime për një Komision të së Vërtetës dhe të Pajtimit për Serbi dhe për Bosnje. Mirëpo, ekziston rreziku që, po qe se nuk sigurohet pjesëmarrja e popullit nga i tërë rajoni, puna e këtyre Komisioneve do të përfundojë, në rastin më të mirë me shpjegime gjysmë të vërteta ose, në rastin më të keq, me shpjegime rivale kombëtare. Për këtë arsye, një proces rajonal është shumë i rëndësishëm. Një proces i tillë do të duhej të mirret edhe me masat për ndërtimin e besimit, si për shembull me kërkimin e të zhdukurve dhe lirin e ndërsjellë të të burgosurve.

Trashëgiminë kulturore. Në Beograd, Komisioni është njoftuar me shkatërrimin e trashëgimisë kulturore serbe në Kosovë gjatë vitit të fundit. Në Banja Llukë, në maj 2001, janë mbajtur demonstrata kundër përpjekjeve të myslimanëve për t'i rindërtuar xhamitë e shkatërruara gjatë luftës. Ky rajon është i pasur me histori, dhe monumentet e kombeve dhe të feve të ndryshme janë pjesë e trashëgimisë së gjerë ballkanike. Andaj duhet diskutuar mbi mënyrat e mbrojtjes kulturore në të tërë rajonin. Angazhimi individual i shteteve për ta mbrojtur pronën e tyre, në bashkëpunim me fqinjët e tyre, është test i pjekurisë së tyre politike.

Sigurinë. Një strukturë e integruar e sigurisë që e përfshin të tërë rajonin, me pjesëmarrje të KFOR-it dhe të forcave vendëse, mund të jetë një mënyrë për profesionalizimin e forcave që njëkohësisht do t'i parandalonte konfliktet. Bashkëpunimi në mes të KFOR-it dhe forcave serbe në Luginën e Preshevës mund ta paraqesë një model për bashkëpunime të ngjajshme.

Këta shembuj nuk janë gjithëpërfshirës; kësaj liste mund t'i shtohen, po ashtu, edhe çështje të tjera, si shëndetësia, arsimi dhe mediat.

Propozimet për institucionalizimin e kornizës rajonale. Momentalisht ekziston një numër i madh i iniciativave rajonale – Pakti i Stabilitetit, Marrëveshjet e Stabilizimit dhe të Asociimit me UE-në, marrëveshja e Partneritetit me NATO-n, si dhe llojet e ndryshme të pjesëmarrjes ndërkombëtare, UNMIK-u, Zyra e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnje dhe prania e NATO-s në Shqipëri dhe në Maqedoni. Ajo që mungon është një qasje e qartë politike dhe angazhim konstant politik në rajon. Për shembull Pakti i Stabilitetit, i cili filloi përplot solemnitet në Sarajevë, në verën 1999, u përcoll me shpresa të mëdha, mirëpo që atëherë e ka humbur momentin e vet politik. Do të ishte më rëndësi që të diskutohen mënyrat të cilat do t'i përmbledhnin të gjitha këto iniciativa në një kornizë të vetme ballkanike, të lidhur me UE-në, me kryeqendër në rajon, ndoshta në Sarajevë.

Një proces i tillë rajonal kërkon autorizim nga niveli më i lartë, i qeverive rajonale si dhe nga Bashkësia Ndërkombëtare, mirëpo ky duhet ta parashtrojë një kornizë për një proces “nga poshtë,” e ku do të kyçeshin të gjitha nivelet e shoqërisë, në një diskutim gjithëpërfshirës. Në një masë, negociatat rreth Luginës së Preshevës janë një model i një procesi të këtillë.

Përfundimi

Raporti ynë e kishte qëndrimin që në disa raste të jashtëzakonshme, që e paraqesin një katastrofë humanitare që pritet të ndodhë, ose e cila është në zhvillim e sipër, përdorimi i forcave ndërkombëtare pa autorizimin e Kombeve të Bashkuara është i arsyeshëm. Në rrethana të tilla është qenësore që përdorimi i dhunës të jetë në përputhje të rreptë me një varg të rregullave të shënuara në kornizën e parimeve të hartuara për cilindo rast të intervenimit humanitar (Përmbajtjen e kësaj kornize mund ta lexoni në Raportin për Kosovën). Raporti po ashtu e përkrah qëndrimin shtesë që, edhe po qe se intervenimi humanitar është i përkrahur nga autoriteti i KB-së, është obligim ndërkombëtar që këto rregulla të respektohen.

Komisioni është i mendimit se ngjarjet në Kosovë që nga viti 1999 na e japin të drejtën ta ritheksojmë qëndrimin tonë, duke e pasur tani edhe vetëbesimin e fituar nga përvoja ekzistuese. Me qëllim që këtyre rregullave, ose një formulimi paksa të ndryshuar të tyre, t'u jipet forcë, është me rëndësi që ato të jenë edhe formalisht të përvetësuar nga organet e KB-së, dhe, në veçanti, nga Këshilli i Sigurimit dhe Kuvendi i Përgjithshëm. Mund të jetë e dobishme që Komisionit Ndërkombëtar Ligjor t'i besohet detyra e përpilimit të një teksti autoritativ në bazë të kornizës së parimeve tona.

Përvoja e fituar pas botimit të Raportit e demonstroi rëndësinë (si dhe pamjaftueshmërinë) e kornizës sonë rreth obligimeve të përfaqësuesve ndërkombëtarë edhe pas intervenimit në Kosovë. Një rëndësi të posaçme këtu kanë aplikimi i Parimeve 9 dhe 11 të kornizës. Parimi 9 thotë se: “ligji i luftës dhe ai ndërkombëtar humanitar duhet të respektohen në një mënyrë edhe më strikte sesa në operacionet e rëndomta ushtarake. Kjo vlen për të gjitha fazat e operacionit ushtarak, duke e përfshirë këtu edhe stacionimin përfundimtar pas armëpushimit.” Komisioni mendon që KFOR-i është për çdo lëvdatë për shkak të respektimit të ligjeve të sipërpërmendura gjatë periudhës së deritashme. Mirëpo KFOR-i dhe UNMIK-u nuk ia kanë kushtuar kujdesin e duhur mbrojtjes së pakicave të kërcënuara, dhe në veçanti gjatë fazës së parë të stacionimit të tyre, duke e lejuar në këtë mënyrë procesin i cili nganjëherë quhet “spastrimi i anasjelltë etnik,” e me të cilin rast në Kosovë është abuzuar pakica serbe dhe aleatët e saj, në veçanti romët. Është dashur që mbrojtjes së civilëve në Kosovë t'i kushtohet kujdes më i madh që nga fillimi, dhe të theksohet respektimi i ligjit. Gjithashtu,

kufijt është dashur të sigurohen më mirë, si dhe të parandalohet furnizimi i grupeve të armatosura në ZTS në Serbi dhe Maqedoni. Duke i patur parasysh këto zhvillime, fjalia e dytë e Parimit 9 duhet të riformulohet dhe të thotë: “Kjo vlen për të gjitha fazat e operacionit ushtarak, duke përfshirë këtu edhe stacionimin përfundimtar pas armëpushimit, dhe imponon detyrë të veçantë mbi forcat ushtarake dhe homologët e saj administrativ, që t’i japin përparësi maksimale mbrojtjes së pjesëve të rezikuara të popullatës civile, duke e përfshirë këtu edhe parandalimin e akteve hakmarrëse dhe dënuese.” Dështimi në përbushjen e kësaj detyre definivitetit e ka zvogëluar legjitimitetin e intervenimit të NATO-s, por jo deri në atë shkallë që Komisioni të mos e përkrah edhe më tutje intervenimin e vitit 1999, pasi që ky intervenim rezultoi në përfundimin një katastrofe humnitare, e cila sipas të gjitha gjasave pa intervenimin e NATO-s do të rezultonte në një abuzim masiv dhe të vazhdueshëm të popullatës shumicë e cila jeton në Kosovë.

Në përgjithësi, Komisioni konkludon që zhvillimet e fundit në Ballkan e theksojnë rëndësinë e propozimeve të dhëna në Raportin për Kosovën. Larg asaj që të jetë shkas për shtyerjen e zgjidhjes përfundimtare të konfliktit kosovar, rënia e Millosheviqit nga pushteti vetëm jep arsye shtesë për arritjen e një marrëveshjeje në mes të Serbisë dhe Kosovës mbi statusin final të Kosovës. Mirëpo, është e qartë që Bashkësia Ndërkombëtare, dhe në veçanti fuqitë perëndimore të cilat e kanë përkrahur intervenimin, dhe që rrjedhimisht e kanë një obligim të konsiderueshëm, duhen të bëjnë tryzni në këto dy palë që ta shfrytëzojnë këtë rast. Gjithsesi, ekziston rreziku që fuqitë perëndimore t’i përsërisin gabimet e tyre historike të bëra ndaj Kosovës në fillim të viteve 1990: duke mos e përkrahur rezistencën paqësore kundër dhunës serbe dhe duke e përjashtuar çështjen e Kosovës nga negociatat e Dejtonit, Bashkësia Ndërkombëtare lejoi që konflikti të keqësohet dhe, më tutje, kosovarëve ua dërgoi mesazhin e qartë se botës se jashtme përshtypje i bën vetëm dhuna. Ishte kjo ajo e cila rezultoi në krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ky gabim mund të përsëritet. Qeveritë perëndimore duhet t’i japin zgjidhjes së çështjes së statusit të Kosovës të njëjtën rëndësi të cilën ia dhanë arrestimit të Millosheviqit pas rënies së tij nga pushteti. Të njëjtat argumente që tash bëhen kundër shqyrtimit të çështjes së statusit të Kosovës, janë bërë edhe kundër ngulmimit të Perëndimit që Millosheviq të dorëzohet në Hagë. Në fund doli që dorëzimi i Millosheviqit ishte një hap i madh drejt demokratizimit të Serbisë. Është shumë e mundur që vendimi mbi statusin përfundimtar të Kosovës mund të ketë pasoja pozitive, ndërkohë që moszgjidhja e çështjes së statusit të Kosovës qysh tani ka pasoja negative. Është pasiguria ajo e cila i ka kontribuar shfaqjes së dhunës, si në Kosovë ashtu edhe në shtetet fqinje. Po

ashtu, kjo situatë udhëheqësve politik kosovarë u ofron fare pak motivim për ta bërë atë në të cilën Bashkësia Ndërkombëtare dështoi: ta krijojnë një gjendje të sigurt të brendshme dhe të jashtme.

Zgjedhjet kosovare të nëntorit 2001 e ofrojnë edhe një rast për propozimin e pavarësisë së kushtëzuar. Bashkësia Ndërkombëtare duhet t'i parandalojë konfliktet e ardhshme duke e hapur çështjen e pavarësisë. Ndërkohë, udhëheqësia politike kosovare duhet ta shfrytëzojë muajin e mjaltit i cili vie pas zgjedhjeve për të filluar jetësimin e kushteve të marrëveshjes.

Komisioni është ende i mendimit që intervenimi i NATO-s në Kosovë ishte legjitim. Mirëpo, legjitimiteti i intervenimit mund të çenohet nga dështimi i Bashkësisë Ndërkombëtare për t'u angazhuar fuqimisht për ardhmërinë e Kosovës dhe të rajonit, pra për të ndërmarrë nisma politike me përkrahje adekuate ushtarake dhe ekonomike të cilat janë të nevojshme për një zgjidhje afatgjatë. Mendimi ynë është që këto masa nënkuptohen me angazhimin e Bashkësisë Ndërkombëtare për pavarësinë e kushtëzuar të Kosovës, dhe për një proces të dialogut dhe të bashkëpunimit në rajon. Të gjithë ata që morën pjesë në intervenimin e NATO-s, kanë përgjegjësi që të sigurojnë që legjitimiteti i këtij intervenimi të përkrahet me një qasje konstruktive të vazhdueshme.

Fusnotat

1. Anëtarët e Komisionit biseduan me Ivan Benderin, këshilltar i Zëvendës Kryeministrit Qoviq, i cili ishte negociues i marrëveshjes. Benderi është anëtar i ri i qeverisë; ai më parë ishte student aktivist i cili i kishte përkrahur studentët kosovarë në fushatën e tyre për jetësimin e Marrëveshjes për Arsim të vjeshtës së vitit 1997 (shih Raporti për Kosovën, Kapitulli 1). Atë Qoviqi e kishte dërguar në rajon, ku ai i kaloi disa muaj duke i vizituar fshatrat, duke biseduar me popullatën lokale për problemet me të cilat ata ballafaqoheshin, e në të cilën mënyrë e fitoi besimin e tyre. Ai madje edhe u ndihmonte edhe gjatë punës me bagëti. Një qasje e tillë, nga masat kah elitat padyshim se i ka mëkëmbur themelet e marrëveshjes.

2. Shih Raportin e Human Rights Watch për Maqedoninë: www.hrw.org.

3. Shih Iniciativën për Stabilitet në Mal të Zi: “Retorika dhe Reforma: Një Studim i Ndërtimit të Institucioneve në Mal të Zi, 1998-2001”, publikuar më 1 qershor 2001, në Podgoricë dhe Berlin. Teksti mund të gjindet në: www.esiweb.org.

4. Flaka Surroi, e cila e përfaqëson shoqërinë civile në komisionin punues për kornizën kushtetuese, dha dorëheqje. Arsyet, të cilat ajo i dha në shpjegimin e dorëheqjes së saj janë këto: “Së pari, Korniza Kushtetuese është aprovuar pa e pyetur fare popullin e Kosovës. Korniza është shkruar nga një grup i profesionistëve dhe është diskutuar vetëm me partitë politike. Nuk duhet cekur fare atë që shoqëria civile ishte e injoruar në tërësi. Më tutje, sipas neneve të këtij dokumenti, Kosova do t’i zgjedhë strukturat vetqeverisëse të cilat do të kenë autoritet fare të vogël. Përfundimisht, unë nuk mund të jem anëtare e një ekipi i cili do t’i përpilojë rregullat për zgjedhjet të cilat do t’i paraprijnë krijimit të një sistemi sipas të cilit pothuaj i tërë pushteti do të jetë i përqendruar në një njeri dhe në ndihmësit e tij; pastaj, rregullat për zgjedhjen e asamblesë, forca legjislativë e të cilës gjithmonë do të jetë e kërcënuar nga vetoja; si dhe rregullat për vendosjen e një presidenti i cili vetëm do të ndajë shpërblime dhe shpreh falënderime.”

5. Një përshtypje e njëjtë është shprehur nga Ministri i Jashtëm i Shqipërisë Paskal Milo: “Ne dëshirojmë që këta kufij të jenë më pak të rëndësishëm. Ne mendojmë t’i bashkangjitemi UE-së, prandaj edhe dëshirojmë që ky të jetë një regjion i

bashkëpunimit. Filozofia e nacionalizmit dhe ekstremizmit është në kundërshtim me parimet e Evropës së Bashkuar. Nacionalistët dhe ekstremistët dëshirojnë t'i mbyllin kufijtë dhe të krijojnë shtete të vogla kombëtare. Për ne kjo do të ishte kontraproduktive.” (Cituar nga Tim Judah, “Shqipëria e Madhe?” në magazinën Survival, Vol. 43, No 2, 2001, faqe 16).

Shkurtesat

DPA	Partia Radikale Shqiptare në Maqedoni (Radical Albanian Party in Macedonia);
EU	Unioni Evropian (UE - European Union);
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë (FRY - Federal Republic of Yugoslavia);
GDP	Bruto Prodhimi Kombëtar (Gross Domestic Product);
ZTS	Zona Tokësore e Sigurisë në kufirin e Kosovës (GSZ - Ground Safety Zone on border of Kosovo);
HDZ	Bashkësia Demokratike Kroate;
ICTY	Tribunali Ndërkombëtar për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi (International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia);
KFOR	Forca (Ndërkombëtare e Sigurisë) e Kosovës (Kosovo (International Security) Force);
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës;
LPK	Levizja Popullore e Kosovës;
NATO	Organizata e Traktatit Veri-Atlantik (North Atlantic Treaty Organisation);
UÇK	Ushtria Çlirimtare Kombëtare e Maqedonisë (NLA - The National Liberation Army in Macedonia);
SDA	Partia e Aksionit Demokratik, e Bosnjes dhe Hercegovinës;
SRSG	Përfaqësuesi Special i Sekretarit Gjeneral (Special Representative of the Secretary General);
UÇPMB	Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit;
UNMIK	Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë;
VMRO	Parti nacionaliste radikale sllave e Maqedonisë.

Të dhëna mbi komisionin

Nisma për krijimin e Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën është ndërmarrë nga Kryeministri i Suedisë, z. Göran Persson, i cili ishte i brengosur nga mungesa e ndonjë analize të pavarur të konfliktit në Kosovë dhe e ndonjë përpjekjeje të mirëfilltë për hulumtimin e mësimeve që do të duhej të nxirreshin nga ky konflikt. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, z. Kofi Annan me të cilin ai e përpiloi këtë ide, i dha përkrahje projektit.

Kryeministri Persson e shpalli themelimin e Komisionit më 6 gusht 1999. Përfshirja e drejtpërdrejtë e qeverisë suedeze në Komision është shtrirë vetëm deri në ftesën e cila iu bë gjykatësit Richard Goldstone të Afrikës së Jugut dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Qendrës Ndërkombëtare Olaf Palme të Stokholmit, z.-t Carl Tham, për t'i marrë rolet e kryesuesit përkatësisht bashkëkryesuesit.

Përcaktimi i 11 anëtarëve të tjerë të Komisionit është bërë pas ftesave që iu janë bërë individëve të caktuar nga gjykatësi Goldstone dhe z. Tham. Duke e patur parasysh natyrën e ndieshme të kësaj nisme – numrin shumë të madh të aktorëve ndërkombëtarë që janë shqyrtuar nga Komisioni – zgjedhja është bërë duke u mbështetur në ekspertizën e ditur dhe duke e marrë parasysh përbërjen gjinore dhe gjeografike të Komisionit.

Anëtarët e Komisionit janë takuar gjashtë herë:

Shtator 1999 - Stokholm;

Dhjetor 1999 - Nju Jork;

Prill 2000 - Budapest;

Qershor 2000 - Firencë;

Gusht 2000 - Johaneshburg;

Shtator 2001 - Stokholm.

Pas lëshimit të Raportit, Komisioni i ka patur 20 seminare në Amerikën Veriore, Evropë dhe Japoni. Ky po ashtu ka patur konsultime me qeveri, përfshirë këtu ato të Shteteve të Bashkuara dhe të Republikës Federale të Jugosllavisë.

Deklarata e misionit e 21 shtatorit 1999

Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën do t'i hulumtojë zhvillimet vendimtare para, gjatë dhe pas luftës së Kosovës, duke i përfshirë këtu shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut në rajon. Komisioni do ta prezentojë një analizë të holësishme dhe objektive të opsioneve që kanë qenë në dispozicion të Bashkësisë Ndërkombëtare për t'u ballafaquar me krizën. Ky do të përqendrohet në burimet e krizës së Kosovës, në përpjekjet diplomatike për përfundimin e konfliktit dhe në rolin e Kombeve të Bashkuara dhe të vendimit të NATO-s që të intervenojë ushtarakisht. Ky do ta hulumtojë krizën rezultuese të refugjatëve duke i përfshirë reagimet e Bashkësisë Ndërkombëtare për ta zgjidhur këtë krizë. Po ashtu, do të shqyrtohen edhe pasojat e konfliktit në shtetet e rajonit dhe në shtetet e tjera. Për më tepër, Komisioni do ta vlerësojë rolin të cilin gjatë luftës së Kosovës e patën punëtorët humanitarë, OJQ-të dhe mediat. Në fund, Komisioni do t'i identifikojë normat e ligjeve dhe të diplomacisë ndërkombëtare që dolën në shesh nga lufta e Kosovës, dhe përshtatshmërinë e normave dhe të institucioneve të tashme për parandalimin apo reagimin në krizat e ngjashme në të ardhmen.

Si shtesë, Komisioni do t'i diskutojë statusin e ardhshëm të Kosovës, mësimet e nxjerra për Kosovën dhe mësimet e nxjerra për të ardhmen.

Anëtarët e komisionit

Kryesues: Richard Goldstone, Afrikë e Jugut

Bashkëkryesues: Carl Tham, Suedi

Anëtarë:

Grâce d'Almeida, Benin ¹

Hanan Ashrawi, Palestinë ²

Akiko Domoto, Japoni

Richard Falk, SHBA

Oleg Grinevsky, Rusi ³

Michael Ignatieff, Kanadë

Mary Kaldor, Mbretëria e Bashkuar

Martha Minow, SHBA

Jacques Rupnik, Francë

Theo Sommer, Gjermani

Jan Urban, Republika Çeke

Ndihmës të Komisionit:

Mark Ellis, këshilltar ligjor ⁴

Pia Övelius, drejtoreshë

Anki Wood, shtyp

Liam Mahony, redaktim ⁴

Nicole Fritz, ⁴ Estelle Dehon ⁴ dhe Tung Chan ⁴

Ekipi Statistikor në Washington: Scott Carlsson, ⁴

Charles Rudnick, ⁴ Randy Clark, ⁴ Wendy Betts ⁴

Komisioni i shpreh falënderime të ngrohta të gjithë atyre që e bënë të mundur Vazhdimin e Raportit për Kosovën.

¹ Fatkeqësisht, Grâce d'Almeida nuk ishte në gjendje që të merr pjesë në punën gjatë përpilimit të këtij vazhdimi të Raportit, për shkak të angazhimeve të tjera urgjente

² Fatkeqësisht, përkushtimet që Dr. Ashrawi i kishte ndaj nismave paqësore në Lindjen e Mesme i lejuan që të mirrte pjesë vetëm në takimin e parë të Komisionit, kështu që ajo nuk iu bashkua Raportit

³ Fatkeqësisht problemet shëndetësore e penguan ambasadorin Grinevsky që të merr pjesë në më shumë se sa në takimin e parë të Komisionit, kështu që edhe ky nuk iu bashkua Raportit


⁴ Ka të bëjë vetëm me Raportin për Kosovën

Kontributet financiare dhe të tjera

Një kontribut i madh financiar e dha Qeveria e Suedisë. Ky është plotësuar me kontribute financiare nga Qeveria e Kanadasë, Fondacioni Ford, Fondacioni Carnegie dhe Fondacioni i Paqes Sasakawa. Kontribute përmes mikpritjes së takimeve të Fondacionit dhe mbajtjes së seminareve për nevojat e Komisionit janë dhënë nga Unioni Kooperativ Suedez, Shkolla e Drejtësisë e Universitetit të Nju Jorkut, Fondacioni Carnegie për Paqe, Fondacioni Soros, Universiteti i Evropës Qendrore, ABA/CEELI, Instituti i Shteteve të Bashkuara për Paqe, Universiteti i Uituotersrandit, dhe Instituti për Çështje Ndërkombëtare i Afrikës së Jugut.

Katalogimi në publikim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës



Për KIPRED-in

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave ka për qëllim të përkrahë vlerat demokratike në Kosovë përmes trajnimeve dhe analizave të pavarura të politikave publike.

Trajnimet kryesisht fokusohen në zhvillimin e partive politike përmes Internet Akademisë për Demokraci, e zhvilluar në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare Olof Palme nga Suedia.

Kërkimet fokusohen në botimin e analizave të pavarura në fusha si qeverisja e mirë, administrata, zhvillimi i partive politike, bashkëpunimi rajonal, politika ekonomike dhe qeverisja lokale.

KIPRED-i financohet nga fondacioni suedez “Olof Palme International Center” dhe nga fondacioni amerikan “Rockefeller Brother’s Fund”.

KIPRED

Kodra e Diellit, Rr. III, Ll. 39

Prishtinë, Kosovë (UNMIK)

Tel/Fax: +381 (0) 38 555 887

Info: kipred@hotmail.com

www.kipred.net

Përkrahur nga:

